



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 21 .02.2013  
Nr. 0204-148

**PËR:** Avni Kastrati, Kryetar i Komunës së Mitrovicës  
Rrustem Musa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS  
SË MITROVICËS, Nr. 02/06 - 1460/19 Pranuar me datë, 11.02.2013**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-04, Ligjin për Policinë Nr 04/L - 76, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 02/06 -1460/19 të miratuar me datë 31.01.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr. 02/06 -1460/19 për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL**  
**Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së**  
**Arkivit të MAPL-së.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 21 .02.2013  
br. 0204-148

**Za:** Avni Kastrati, Gradonačelnik opštine Mitrovica  
Rrustem Musa, Predsedavajući Skupštine opštine Mitrovica

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluke opštine Mitrovica br. 02/06 - 1460/19 Primijeno  
dana , 11.02.2013

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, zakona za policiju br 04/z - 76, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim adminstativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 02/06 -1460/19 odobreno dana 31.01.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi .

Odluka br. 02/06 -1460/19 o osnivanju opštinskog saveta za bezbednosti zajednice.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,  
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës**  
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

## **KUVENDI I KOMUNËS**

**Nr. 02/06- 1460/19 dt. 31.01.2013**

**Mitrovicë**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 10 paragrafi 4 dhe nenit 23 paragrafi 2 pika d të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 7 të Ligjit Nr. 04/-L-076 Për policinë dhe të dispozitave të nenit 1, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL për Këshillat komunale për siguri në bashkësi, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 31.01.2013 pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës për themelimit të Këshillit Komunal për siguri në bashkësi; sjell këtë:

### **VENDIM**

#### **Për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në bashkësi**

1. Me këtë vendim **THEMELOHET** Këshilli Komunal për siguri në bashkësi.
2. Këshilli Komunal për siguri në bashkësi do të ketë këtë përbërje:
  - Kryetari i Komunës – Kryesues i Këshillit,
  - Komandanti i Stacionit të Policisë,
  - Një përfaqësues i FSK-së;
  - Një përfaqësues i secilës bashkësi fetare;
  - Një përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës;
  - Kryesuesja e Komitetit për Komunitete;
  - Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit
  - Drejtori i Drejtorisë së Arsimit;
  - Sekretari i Kuvendit;
  - Përfaqësuesi i Zyrës për komunitete dhe kthim;
  - Zyrtarja për barazi gjinore
  - Kryetari i këshillit të prindërve të arsimit të komunës;
  - Një përfaqësues i Këshillit lokal për siguri publike,
  - Kryesuesi i EVSB-së (ekipet vepruese për siguri në bashkësi); dhe
  - Një përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSB-së janë:
  - 3.1 Përgatitja e Planit vjetor të punës dhe zhvillimi i projekteve për rritjen dhe përmirësimin e sigurisë në bashkësi.
  - 3.2 Identifikimi i dukurive negative, që tentojnë të prishin sigurinë publike dhe rekomandojnë planet e veprimit.
  - 3.3 Bashkëpunimi me policinë për parandalimin e veprimeve, të cilat e kërcënojnë sigurinë në bashkësi.

- 3.4 Bashkëpunimi me institucionet qendrore, që merren me sigurinë publike me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurt në bashkësi.
- 3.5 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi, që i tejkalojnë kufijtë e Komunës së tyre.
- 3.6 Të kërkojë nga Kuvendi i Komunës financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë.
- 3.7 Përmes Komunës të kërkojë nga ndonjë organizatë joqeveritare financimin e projekteve të lidhura me sigurinë e bashkësisë, fton në takimet e tyre përfaqësuesit e MPB-së DSB.
- 3.8 Fton përfaqësues nga institucionet qeveritare të mediave ose përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që të marrin pjesë në takimet e KKSB-së.
- 3.9 Kërkon nga policia përgjegjëse për rastet, që janë me rëndësi për sigurinë e bashkësisë duke mos ndërhyrë në procesin e hetimeve policore.
- 3.10 Mbatja e takimeve të rregullta ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrativ.
4. Funkzioni i KKSB-së detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të KKSB-së përfaqësimi i Komuniteteve në KKSB, mbledhjet e KKSB-së, pjesëmarrja në mbledhje, vendimmarrja zëvendësimi i anëtarëve të KKSB-së, dorëheqja bashkëpunimi, raportimi, mbikëqyrja etj., rregullohen me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL.
5. Anëtarët e Këshillit Komunal për siguri në bashkësi sipas pikës 2 të këtij vendimi për punën e tyre paguhen nga Buxheti i Komunës, kompensimi për anëtarë të KKSB-së është 50 € për pjesëmarrje në takime (ekuivalent me kompensimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, siç parashihet me nenin 9 të UA Nr. 27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL). Kompensimi për takimet e KKSB-së bëhet vetëm për 6 takime brenda vitit kalendarik.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
7. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb – faqen e Komunës.

Mitrovicë



Kryesuesi i Kuvendit

*[Signature]*  
Dre Rustem MUSA

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryetarit të Komunës
- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 Arkivit